



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-60/01-8851 datë:20.03.2018



Npi – 01/64 datë: 29.03.2018

Në bazë të nenit 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 58.3 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, si dhe nenit 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Kuvendi i Komunës pasi analizoi propozimin e Zyrës Kryesore Financiare, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2018, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS – SHTIME Nr.01-060/01-6636-38 DATË: 09.03.2018 PËR NDARJEN E TË HYRAVE TË BARTURA NGA VITI 2017

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën 29.03.2018, me shumicën e votave aprovoi Vendimin për korrigjimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Nr.01-060/01-6636-38 datë: 09.03.2018, për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2017, në shumën prej 1,121.00€ sipas kësaj table:

Nr.	Kodi i OB	Kodi Ekonomik	Kodi i propozuar i programit për vitin 2018	Kodi i projektit në vitin 2018	Programi Buxhetor	Emërtimi i projektit	Ndryshimi i propozuar për vitin 2018 në €
1	617	30	660(66340)	45315	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Projektet e infrastruktures me participim	1,121.00
						Gjithsej	1,121.00

II

Ndryshimi bëhet tek pika 1 e tabelës së vendimit Nr.01-060/01-6636-38, ku nga shuma 59,853.70€ rritet në shumën 60,974.70€ dhe ka të bëjë me Kategorinë e Shpenzimeve Kapitale të projektet e infrastruktures me participim. Propozim ndryshimi ka të bëjë me shumën prej 1,121.00€ e cila e rritë shumën totale të të Hyrave Vetanake për bartje nga 188,294.02€ në shumën 189,415.02€.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Financa dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj-



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-60/01-8851 datë:20.03.2018



Npi – 01/65 datë: 29.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pika (f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205 të datës 28 tetor 2010. Kryetari i Komunës së Shtimes, për qëllim të zgjerimit të rrugëve "15 Janari" dhe "Wiliam Wolker"- Reçak, me shkresën Nr.06/42 dt.20.03.2018, i propozon Kuvendit të Komunës shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesë të Ngastrës Kadastrale Nr.P-00766-1; Me sipërfaqe prej 185m² (njëqind e tetëdhjetë e pesë metra katror); Zona Kadastrale – Reçak; Evidentuar pronë e Skender (Bajram) Bajrami nga fshati Reçak.

Kuvendi i Komunës duke marrë për bazë propozimin e Kryetarit si dhe Rekomandimet e Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2018, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PRONËS ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën: 29.03.2018, me shumicën e votave aprovoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.P-00766-1; Me sipërfaqe prej 185m² (njëqind e tetëdhjetë e pesë metra katror); Zona Kadastrale – Reçak; Evidentuar pronë e Skender (Bajram) Bajrami nga fshati Reçak.

II

A r s y e t i m; Shpallja e pjesës të Ngastrës Kadastrale Nr.P-00766-1, me interes të përgjithshëm është bërë për qëllim të zgjerimit të rrugëve "15 Janari" dhe "Wiliam Wolker", të cilat shpëjnë te "Memoriali Përkujtimor i Masakrës së Raçakut".

III

Me këtë vendim obligohet ekzekutivi i Komunës së Shtimes që të fillojë procedurat e Shpronësimit, sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit

Medina Brahaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-60/01-8851 datë:20.03.2018



Npi – 01/66 datë: 29.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pika (f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205 të datës 28 tetor 2010. Kryetari i Komunës së Shtimes, për qëllim të zgjerimit të rrugës "15 Janari" – Reçak, me shkresën Nr.06/42 dt.20.03.2018, i propozon Kuvendit të Komunës, shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.P-00765-1; Me sipërfaqe prej 95m², (nëntëdhjetë e pesë metra katror); Zona Kadastrale – Reçak; Evidentuar pronë e Azir (Riza) Smaili nga fshati Reçak.

Kuvendi i Komunës duke marrë për bazë propozimin e Kryetarit si dhe Rekomandimet e Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2018, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PRONËS ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën: 29.03.2018, me shumicën e votave aprovoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.P-00765-1; Me sipërfaqe prej 95m², (nëntëdhjetë e pesë metra katror); Zona Kadastrale – Reçak; Evidentuar pronë e Azir (Riza) Smaili nga fshati Reçak.

II

A r s y e t i m; Shpallja e pjesës së Ngastrës Kadastrale Nr.P-00765-1, me interes të përgjithshëm është bërë për qëllim të zgjerimit të rrugës "15 Janari" e cila të shpie te "Memoriali Përkujtimor i Masakrës së Raçakut".

III

Me këtë vendim obligohet ekzekutivi i Komunës së Shtimes që të fillojë procedurat e Shpronësimit, sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



Npi – 01/67 datë: 29.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pika (f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205 të datës 28 tetor 2010. Kryetari i Komunës së Shtimes, për qëllim të zgjerimit të rrugës "15 Janari"- Reçak, me shkresën Nr.06/42 dt.20.03.2018, i propozon Kuvendit të Komunës, shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.P-00765-2; Me sipërfaqe prej 66m², (gjashtëdhjetë e gjashtë metra katror); Zona Kadastrale – Reçak; Evidentuar pronë e Hamit (Riza) Smajli nga fshati Reçak.

Kuvendi i Komunës duke marrë për bazë propozimin e Kryetarit si dhe Rekomandimet e Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2018, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PRONËS ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën: 29.03.2018, me shumicën e votave aprovoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.P-00765-2; Me sipërfaqe prej 66m², (gjashtëdhjetë e gjashtë metra katror); Zona Kadastrale – Reçak; Evidentuar pronë e Hamit (Riza) Smajli nga fshati Reçak.

II

A r s y e t i m; Shpallja e pjesës së Ngastrës Kadastrale Nr.P-00765-2, me interes të përgjithshëm është bërë për qëllim të zgjerimit të rrugës " 15 Janari" e cila të shpie deri te "Memoriali Përkujtimor i Masakrës së Raçakut".

III

Me këtë vendim obligohet ekzekutivi i Komunës së Shtimes që të fillojë procedurat e Shpronësimit, sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



Npi – 01/68 datë: 29.03.2018

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pika (f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205 të datës 28 tetor 2010. Kryetari i Komunës së Shtimes, për qëllim të zgjerimit të rrugës "Xhemshir Xhemshiri" në fshatin Petrovë, me shkresën Nr.06/43 dt.20.03.2018, i propozon Kuvendit të Komunës, shpalljen me interes të përgjithshëm të pjesës së Ngatrës Kadastrale Nr.P-00774-2; Me sipërfaqe prej 44m², (katërdhjetë e katër metra katror); Zona Kadastrale – Petrovë; Evidentuar pronë e Shpejtim (Shefki) Rexhaj nga fshati Petrovë. Kuvendi i Komunës duke marrë për bazë propozimin e Kryetarit si dhe Rekomandimet e Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2018, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PRONËS ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën: 29.03.2018, me shumicën e votave aprovoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr.P-00774-2; Me sipërfaqe prej 44m², (katërdhjetë e katër metra katror); Zona Kadastrale – Petrovë; Evidentuar pronë e Shpejtim (Shefki) Rexhaj nga fshati Petrovë.

II

A r s y e t i m; Shpallja e pjesës së Ngatrës Kadastrale Nr.P-00774-2, me interes të përgjithshëm është bërë për qëllim të zgjerimit të rrugës "Xhemshir Xhemshiri" në fshatin Petrovë.

III

Me këtë vendim obligohet ekzekutivi i Komunës së Shtimes që të fillojë procedurat e Shpronësimit, sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



Npi – 01/69 datë:29.03.2018

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën me numër: Nr.01-070/05-1105/18, datë: 10.01.2018, të znj. Sabrije Agushi nga fshati Reçak, e cila ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, për të dytën herë që ti ndahen 4 ari truall në Çestë ose ndokund tjetër për ndërtimin e një shtëpie banimi për familjen e sajë, me arsyetimin se është në gjendje të rëndë ekonomike. Në vazhdim ka cekur se është një parcelë e tokës në Çestë të cilën unë e kam rrethuar në sipërfaqe prej 4 ari, kështu që ju lutem ma jepni këtë parcelë ose ndokund tjetër. Kuvendi Komunës, pasi analizoi kërkesën e palës, rekomandimet e Drejtorisë dhe Komitetit për Politikë e Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS, Nr.01-070/05-1105/18 TË SABRIJE AGUSHIT NGA FSHATI REÇAK

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 29.03.2018, me shumicën e votave vendosi që kërkesa, Nr.01-070/05-1105/18 datë: 10.01.2018, e Sabrije Agushi nga fshati Reçak, të refuzohet, sipas rekomandimit të DPUKGJ-së, me arsyetimin se në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale Nr.04/L-144, për raste individuale nuk parashihet dhënie në shfrytëzim e pronës komunale.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-8851 datë:20.03.2018



Npi – 01/70 datë:29.03.2018

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën me numër: Nr.01-070/05-3814/18, datë: 05.02.2018, të z.Sefer Çerkini nga fshati Carralevë, i cili ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, Pëlqim për shfrytëzimin dhe montimin e Gurthyesit në pronën e tij private në fshatin Carralevë në Parcelën Nr. P-72809089-02100-0. Me sipërfaqe 02.98.48. Zona Kadastrale – Carralevë, Kultura - Mal i klasës së 5. Evidentuar në emër të Sefer /Shefqet/ Çerkini nga fshati Carralevë.

Kuvendi Komunës, pasi analizoi kërkesën e palës, rekomandimet e Drejtorisë dhe Komitetit për Politikë e Financa, mori këtë:

V E N D I M

**PËR REFUZIMIN E KËRKESËS, Nr.01-070/05-3814/18
TË SEFER ÇERKINIT NGA FSHATI CARRALEVË**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 29.03.2018, me shumicën e votave vendosi që kërkesa, Nr.01-070/05-3814/18, datë: 05.02.2018, e Sefer Çerkini nga fshati Carralevë, të refuzohet, me arsyetimin se në bazë të Planit Zhvillimor Komunal, nuk lejohet që në atë pjesë të bëhet eksploatimi i tokës si dhe montimi i guroreve. Poashtu Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë një “Plan për mbylljen e guroreve ekzistuese” dhe deri në përfundim të analizave në bazë të këtij plani nuk kemi të drejtë të japim Leje për gurore të reja.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



Npi – 01/71 datë:29.03.2018

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën Nr.01-070/05-7059/18, datë: 06.03.2018 të z.Adnan Salihu, nga fshati Godanc i Ulët, NTP - “Medina Com” i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, ka kërkuar që ti epet për shfrytëzim dhe eksploatim të Gurit, në ngastrën kadastrale Nr.01312-0 në vendin e quajtur “Rrafshi i Feratit”, kultura Mal i klasit të pestë, Zona Kadastrale – Topillë, Fleta Poseduese Nr.00111, evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal Shtime.

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, duke marrë për bazë rekomandimin e Drejtorisë si dhe rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2018, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS, Nr.01-070/05-7059/18 TË ADNAN SALIHUT NGA FSHATI GODANC I ULËT

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 29.03.2018, me shumicën e votave aprovoi vendimin që Kërkesa, Nr.01-070/05-7059/18, datë: 06.03.2018, e Adnan Salihut nga fshati Godanc i ulët, (NTP - “Medina Com”) të Refuzohet, me arsyetimin se kërkesa duhet të trajtohet në përputhje me Ligjin Nr.04/L-144, si vijon:

1. Neni 5 dhe 6, Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër ose afatgjatë të pronës komunale, realizohet përmes konkurrencës së hapur publike, konkursit publik në formë ankandi.
2. Neni 7 Propozimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim e paraqet Kryetari i Komunës në Kuvend, duke dhënë arsyet e interesit publik.
3. Neni 8 Zbatimin e procedurave dhe shqyrtimin e propozimit të Kryetarit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, duhet ta bëjë Komisioni Vlerësues prej 7 anëtarëve, i formuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes.
4. Në nenin 10 janë të përcaktuara rastet e veçanta kur procedurat e konkurrimit nuk zbatohen.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë, Zyrës për Informim dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



Npi – 01/72 datë:29.03.2018

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën Nr.01-070/05-8701/18, datë: 19.03.2018, të z.Fatmir Hysenaj – Petrovë, (N.P.SH. “Vllëzërit e Bashkuar” SHPK) i cili ka kërkuar 5 hektar tokë për shfrytëzim dhe eksploatim të Gurit, në ngastrën kadastrale Nr.01312-0 në vendin e quajtur “Rrafshi i Feratit”, kultura Mal i klasit të pestë, Zona Kadastrale – Topillë-Devetak, Fleta Poseduese Nr.00111, evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal Shtime.

Kuvendi Komunal, pasi analizoi kërkesën e palës, duke marrë për bazë rekomandimin e Drejtorisë si dhe rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2018, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS, Nr.01-070/05-8701/18 TË FATMIR HYSENAJ NGA FSHATI PETROVË

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më 29.03.2018, me shumicën e votave aprovoi vendimin që Kërkesa, Nr.01-070/05-8701/18, datë: 19.03.2018, e Fatmir Hysenaj – Petrovë, (N.P.SH. “Vllëzërit e Bashkuar” SHPK) të Refuzohet, me arsyetimin se kërkesa duhet të trajtohet në përputhje me Ligjin Nr.04/L-144, si vijon:

1. Neni 5 dhe 6, Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër ose afatgjatë të pronës komunale, realizohet përmes konkurrencës së hapur publike, konkursit publik në formë ankandi.
2. Neni 7 Propozimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim e paraqet Kryetari i Komunës në Kuvend, duke dhënë arsyet e interesit publik.
3. Neni 8 Zbatimin e procedurave dhe shqyrtimin e propozimit të Kryetarit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, duhet ta bëjë Komisioni Vlerësues prej 7 anëtarëve, i formuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes.
4. Në nenin 10 janë të përcaktuara rastet e veçanta kur procedurat e konkurrimit nuk zbatohen.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë, Zyrës për Informim dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY
SHTIME / ŠTIMLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E SHTIMES/OPŠTINA ŠTIMLJE

Nr i Prot./Br Prot. 01/76

Nr i Faqeve/Br.strana 9

Data/Danaf: 05-04-2018

SHTIME/ŠTIMLJE

Data/Datum/Date:	05.04.2018
Nr./Br./No	Npi – 01/76
Për/Za/To:	Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal - Prishtinë - Departamenti Ligjor
Përmes/Preko/Through:	Sekretaria e Kuvendit – Zyrtari, z.Idajet Rexhepi
Nga/Od/From:	Kryesuesja e Kuvendit të Komunës znj.Medina Brahaj
Lënda/Predmet/Subject :	FLETËPËRCJELLËSE

Bashkangjitur kësaj shkrese, u dërgojmë Vendimet e aprovuara në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2018 të Kuvendit të Komunës së Shtimes, e mbajtur më 29.03.2018, si vijon:
(Vendimet në gjuhën Shqipe)

Tabela e vendimeve :

Nr	Emërtimi i Akteve nënligjore të aprovuara në Kuvendin e Komunës së Shtimes më 29.03.2018	Numri i Protokolit
1	VENDIM - për Korrigjimin e Vendimit Nr.01-38 për ndarjen e të hyrave nga viti 2017	01/64
2	VENDIM - për shpalljen me interes publik Ng. P-00766-1, Skender Bajrami - Reçak	01/65
3	VENDIM - për shpalljen me interes publik Ng. P-00765-1, Azir Ismaili - Reçak	01/66
4	VENDIM - për shpalljen me interes publik Ng. P-00765-2, Hamit Smajli - Reçak	01/67
5	VENDIM - për shpalljen me interes publik Ng. P-00774-2, Shpejtim Rexhaj - Petrovë	01/68
6	VENDIM - për refuzimin e kërkesës Nr.01-070-05-1105 të Sabrije Agushi-Reçak	01/69
7	VENDIM - për refuzimin e kërkesës Nr.01-070-05-3814 të Sefer Çerkini - Carraleve	01/70
8	VENDIM - për refuzimin e kërkesës Nr.01-070-05-7059 të Adnan Salihu -Godanc i ulët	01/71
9	VENDIM - për refuzimin e kërkesës Nr.01-070-05-8701 të të Fatmir Hysenaj -Petrovë	01/72



Zyrtari i Kuvendit
Idajet Rexhepi

Adresa: Rr. Tiranës, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org
<http://kk.rks-gov.net/shtime>